



RAPORT MONITORIMI ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

2025

Përmbledhje Ekzekutive

Qasja vlerësuese

Metodologjia e monitorimit

Gjetjet e raportit

Objektivi 1: Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij.

Objektivi 2: Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytja dhe sigurinë e digave.

Objektivi 3: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse.

Objektivi 4: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri.

Objektivi 5: Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve / veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja

Konkluzione dhe rekomandime

Hapa të tjera

Aneks

Lista e shkurtesave

GRECO	Grupi i Shteteve kundër korrupsionit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit dhe Riskut
PSV	Procedura Standarte Veprimi
QTTB	Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përmbledhje Ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Prioritizimi i kuadrit antikorrupsion është jetësuar së fundi nëpërmjet: forcimit të kompetencave dhe kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit; koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 Nr. 859, datë 26.12.2024 si edhe të forcimit të kuadrit rregullator dhe të mekanizmave të integritetit në administratën publike.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është përgjegjëse për zbatimin e Aktivitetit A.8.4.2 dhe Masës A.9.3 të SNKK-së, që materializojnë forcimin e integritetit në administratën publike. Në zbatim të këtyre objektivave, gjatë vitit 2024, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, hartoi dhe miratoi instrumentin me karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit: Planin e Integritetit të institucionit, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 568, datë 27.7.2024.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është një instrument i luftës kundër korrupsionit, për të patur një administratë publike profesionale, me etikë, integritet dhe e angazhuar për t'iu shërbyer qytetarëve në fushën e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit dhe të tjerë sektorë nën përgjegjësinë e MBZHR. Ky plan ka të parashikuar masa të identifikuara në 13 fusha të përgjegjësisë institucionale të ministrisë. Plani i Integritetit për vitin 2024-2027 përmban gjithsej 38 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti ishte deri në fund të vitit 2027 dhe kostot financiare të planit do të mbulohen nga buxheti i MBZHR-së.

Në përputhje me kreun 3, pika 3.1 të Planit të Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2025, për statusin e zbatimit të tyre,


informacionin për buxhetin, problematikat e hasura në zbatimin e tyre, përmban të dhëna për veprimtarinë operacionale të njësive (drejtorive) të brendshme kontribuese, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm rregullator, burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.

Për vitin 2025, Plani i Integritetit kishte të parashikuar për zbatim 33 masa/aktivitete, të shpërndara në 5 objektiva, përkatësisht:

- **Objektivi 1:** Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij.
- **Objektivi 2:** Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytja dhe sigurinë e digave.
- **Objektivi 3:** Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse.
- **Objektivi 4:** Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri.
- **Objektivi 5:** Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja.

Nga monitorimi i periudhës janar-dhjetor 2025, rezulton se në totalin prej tridhjetë e tre (33) masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim janë: zbatuar tridhjetë (30) masa/aktivitete, në proces zbatimi kanë mbetur tre (3) masa/aktivitete dhe të pazbatuara zero (0) masa/aktivitete.

Statusi i zbatimit të Planit të Integritetit 2024



Gjatë vitit 2024, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ka punuar për finalizimin e procesit të ristrukturimit me një rritje kapacitetesh nga 180 punonjës në 188 punonjës, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 61, datë 18.4.2024, *“Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”*.

Përsa i perket trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka bashkëpunuar ngushtë me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike dhe organizata ndërkombëtare ku kanë mundur trajnime pranë ASPA-s online dhe fizikisht 88 nëpunës Civil. (Pajisur me certifikatë).

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performances etj. Gjithashtu nga ana tjetër plotëson nevojën për angazhim më të madh të strukturave dhe kapaciteteve teknike të ministrisë në zbatim të parashikimeve të bëra për të mundur një performancë më të mirë institucionale, siç është rekrutimi i plotë i punonjësve ku evidentohet vakanca.

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në MBZHR të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 5 drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të një grupi të brendshëm pune për të cilat ka pasur të parashikuar masa për zbatim për vitin 2025. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator i Integritetit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore).

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Politikave në Fushën e Drejtësisë;
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit.
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural.
- Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse.
- Drejtoria e Programimit dhe Monitorimit të IPARD

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashkuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumenta të hartuara (verifikueshmëria) e të dhëna; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione.

Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Gjetjet e Raportit

■ **Objektivi 1** : Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij


Në funksion të Vlerësimit dhe Monitorimit të Programit IPARD Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin duke u bazuar në 3 nënobjektiva:

1. Akreditim i masave ekzistuese dhe realizimi i thirrjeve në kuadër të Programit IPARD III nga vlerësimi i së cilës janë identifikuar risqet që kanë të bëjnë me mungesën e kontributeve të sakta dhe në kohën e duhur nga institucionet e tjera, mosrespektimin e afateve të raportimeve në DG Agri, mosrealizimin në kohë dhe në mënyrën e duhur të proceseve të punës, personelin e pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar proceset e rëndësishme. Ndër masat, njësitë përgjegjëse kanë përcaktuar si të nevojshëm, ku cilësohen si: bashkëpunimi dhe koordinimi i procesit me institucionet përkatëse, komunikimi i vazhdueshëm, ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me njësinë e burimeve njerëzore.
2. Akreditimi i masave të reja në kuadër të Programit IPARD III nga vlerësimi i së cilës janë identifikuar përsëri risqe që janë pasojë e pamjaftueshmërisë në personel dhe mungesës së kontributeve të sakta dhe në kohën e duhur të proceseve të punës, masat e duhura për t'u ndërmarrë po ashtu mbeten ato të procedurave të rekrutimit, komunikimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm.
3. Realizimi i vlerësimit ex-post për Programin IPARD II, është identifikuar risku i mosrealizimit në kohë të vlerësimit ex-post të Programit IPARD II, për këtë nënobjektiv, masat janë ngushtësisht të lidhura me drejtorinë e prokurimeve lidhur me ndryshimin e regjistrimit të prokurimeve, hartimin e termave të referencës, kontraktimin e fituesit, etj.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Programimit dhe Monitorimit IPARD dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi shtate (7) masa të zbatuar plotësisht. (për nënobjektivin 1 dhe 2)

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të prealizua
Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij.	Nënobjektivi nr. 1	4	4	0	0
	Nënobjektivi nr. 2	2	2	0	0
	Nënobjektivi nr. 3	1	1	0	0

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të prealizuara
Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij.	Masa/ Aktivitete	7	7	0	0



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2025*, për përgatitjen dhe dorëzuar në kohë Raporti Vjetor i Zbatimit të Programit IPARD II 2024 dhe Raporti Përfundimtar i Zbatimit për periudhën 2014-2024, Drejtoria IPARD ka komunikuar dhe bashkëpunuar me të gjitha institucionet e përfshira në përgatitjen e raportit. Informacionet kanë qenë të sakta dhe në kohë. Raporti është dorëzuar në afat dhe me cilësi. Këto raporte janë konsultuar me DG-AGRI dhe janë miratuar nga anëtarët e Komitetit të Monitorimit të IPARD II, si dhe janë respektuar afatet e raportimeve të përcaktuara në bazën ligjore të zbatimit të Programit IPARD.

Përsa i takon plotësimit të stafit, bazuar në organigramën e Autoritetit Menaxhues, në Sektorin e Programimit në janar 2025, u plotësuan 2 vendet vakante "Specialist".

Në lidhje me Programin IPARD III, po vijon puna përgatitore për përgatitjen e stafit të kësaj drejtorie dhe jo vetëm. Janë organizuar trajnime të ndryshme me asistencë nga BE përmes instrumentit të TAIEK; FAO si dhe trajnimeve të ofruara nga ASPA ku stafi i Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë IPARD ka marrë pjesë. Gjithashtu janë realizuar edhe trajnime specifike me fokus masat e reja të programuara nën këtë program.

Sa i përket realizimit të vlerësimit ex-post për programin IPARD II, Autoriteti Menaxhues ka hartuar dhe dorëzuar pranë Komisionit Evropian, brenda afatit, Raportin Final të Vlerësimit Ex-post të Programit IPARD II, si një detyrim i përcaktuar në nenin 58 të Marrëveshjes Sektoriale.

- **Objektivi 2:** Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave.

Përmes këtij objektiwi, synohet ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe të besueshme të ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet rehabilitimit dhe përmirësimit/mirëmbajtjes ciklike të sistemeve kryesore ujitëse dhe kulluese si dhe përmirësimi i strukturave mbrojtëse nga përmbytja.


Ky objektivi përmban një numër prej pesëmbëdhjetë (15) masa specifike:

- Ardhja në kohë e udhëzimeve dhe tavanëve nga Ministria e Financave (MF);
- Mbërritja në kohë dhe me cilësi e informacionit mbi nevojat për fonde nga institucionet e varësisë, drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit;
- Akordimi i plotë i fondeve buxhetore të kërkuara për shpenzime operative dhe investimet;
- Zhvillime të reja lidhur me politikat e qeverisë për prioritetet e zhvillimit rajonal, etj;
- Rakordimi i fondeve të kërkuara gjatë fazës së identifikimit të projekteve;
- Hartimi me cilësi i termave të referencës;
- Përgatitja në kohë e projekteve të zbatimit, sipas termave të referencës;
- Kryerja në kohë e procedurave të prokurimit;
- Ndryshimet e projekt – preventivave gjatë zbatimit;
- Përputhje e grafikut të miratuar të punimeve me kushtet klimaterike të objekteve;
- Kryerja e punës sipas termave të referencës dhe kushteve të kontratës nga supervizori
- Përputhje e grafikut të punimeve me grafikun e likuidimeve.
- Shmangia e situatave të paparashikuara natyrore (përmbytje, termete) që afektojnë infrastrukturën e kullimit/ që ndikojnë në sigurinë e digave/ që afektojnë strukturat e mbrojtjes nga përmbytja.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë Drejtoria e Administrimit të Ujrave dhe Digave dhe Drejtoritë e Ujitjes dhe Kullimit Korçë, Lezhë, Fier, Durrës. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi, dymbëdhjetë (12) masa të zbatuara plotësisht.



Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve					
Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastruktures së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga permbytja dhe sigurinë e digave	Masa/ Aktivitete	15	12	3	0



Në lidhje me përmirësimin e sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, ekipi i menaxhimit të programit është angazhuar në zbatimin në kohë të procedurave të përcaktuara në tre fazat e hartimit të PBA-së, faza strategjike, faza teknike dhe faza përfundimtare.

Në interes të një procesi planifikimi dhe programimi të buxhetit, sa më institucional dhe efektiv, udhëzimet dhe tavanet buxhetore kanë ardhur në kohë. Në bashkëpunimin me drejtorinë e buxhetit në MBZHR dhe me MF është zhvilluar një proces konsultimi i vazhdueshëm, jo vetëm shkresor por edhe takime konsultuese dhe informuese, për të rritur saktësinë e planifikimit dhe efektivitetin e programimit dhe alokimit të buxhetit.

Drejtoria e Administrimit të Ujitjes dhe Digave ka menaxhuar një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe raportimi të gatishmërisë së infrastrukturës së ujitjes dhe kulimit dhe mbrojtjes nga përmbytja. Në këtë kuadër, bazuar në vlerësimet e vazhdueshme, DUK-et kanë hartuar kërkesat buxhetore për vitin në vazhdim, në bazë të një plani të sigurtë investimi, me qëllim shmangien e avarive dhe garantimin e funksionimit të plotë të infrastrukturës. Bazuar në këtë sistem planifikimi dhe vlerësimi të vazhdueshëm, është arritur të menaxhohen të gjitha situatat e mergjencave.

Qëllimet strategjike, të përzgjedhura në strategjinë e ujitjes, në politikat prioritare të MBZHR dhe të qeverisë, kanë shërbuer si referencat kryesore në alokimin e buxhetit. Synimi i tyre është rritja e kapaciteteve dhe konsolidimi i infrastrukturës.

Identifikimi i projekteve të mundshme për investim dhe i gjithë procesi i programimit buxhetor është bërë duke respektuar kërkesat e procesit të programimit të investimeve publike. Në këtë drejtim ka një rakordim të saktë mes kërkesave dhe nevojave për investime dhe rakordimit buxhetor në periudhën 3 vjeçare, fazën e PBA-se, duke garantuar jo vetëm vazhdimësinë e investimeve por edhe buxhetimit të plotë të veprave të ndryshme të ujitjes, kullimit apo mbrojtjes nga përmbytja.

Në këtë kontekst, në drejtorinë e administrimit të ujërave dhe të digave, gjatë vitit 2025, është hartuar metodologjia e vlerësimit dhe përzgjedhjes së projekteve prioritare për investim, pjesë e kërkesave buxhetore nga institucionet e varësisë por edhe nga bashkitë e vendit. Ky dokument, normon një proces shumë të disiplinuar dhe objektiv të vlerësimit, ponderimit/pikëzimit dhe renditjes së kërkesave buxhetore, bazuar në kritere të sakta për eficiencën, koston dhe shumë faktorë të tjerë. Si rezultat i përdorimit të kësaj metodologjie, është ulur në maksimum rrisku për keqpërdorimin e buxhetit dhe është rritur efektiviteti i tij.

Për objektet e infrastrukturës së ujitjes janë elaburuar disa kritere, si më poshtë:

- (1) Kriteri kosto/hektar (vlera e investimit/hektar që impakton) me peshë 50%;
- (2) Kriteri i zonës intensive bujqësore i vlerësuar në 3 nivele (i lartë, mesatar dhe i ulët) me peshë 20%;
- (3) Kriteri i investimeve të realizuara më parë në infrastrukturën e ujitjes;



- (4) Kriteri i tipologjisë së skemës ujitëse që lidhet me domosdoshmërinë prioritare të rehabilitimit dhe aspekte të ndryshme teknike, që konvenon edhe me zonën intensive bujqësore.

Për objektet e mbrotjes nga përmbytja, prioritet marrin ato objekte që kanë riskun më të lartë të përmbytjes dhe që janë në prani të zonave të banuara.

Në hidrovoqe, kanë prioritet objektet me amortizim më të lartë dhe që kanë sipërfaqe më të lartë kullimi.

Përsa i përket zbatimit të buxhetit dhe të investimeve, DUKT janë institucionet përgjegjësie për këtë. Kuadri normativ, rregulloret e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së kanaleve kulluese, të hidrovoqeve dhe të argjinaturave, kanë normuar deri në detaje standarte dhe kërkesa ligjore, të cilat udhëheqin hartimin e TOR-s, përgatitjen e projekteve dhe kryerjen e procedurave të prokurimit.

Gjithashtu për vitin 2025, Ministria e Financave ka akorduar një buxhet të dedikuar për objektet e ujitjes në bashkitë e vendit. Detajimi i objekteve për bashkitë, është bazuar në kriteret e sipërcituar, mbi bazën e analizës së aplikimeve të bëra nga bashkitë, me të dhëna sipas një standardi të përcaktuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Mbi këtë bazë, për periudhën monitorimi, *janar-dhjetor 2025*, në funksion të ofrimit të shërbimeve të qëndrueshme dhe të besueshme të ujitjes dhe kullimit, janë siguruar kërkesat për financime për planifikimin e fondeve. Përsa i përket hartimit të termave të referencës dhe zhvillimi i procesit të prokurimit gjatë vitit 2025, megjithëse ka patur vonesa në nisjen e procedurës së prokurimit, përsëri investimet janë realizuar në masën 97%.

Gjithashtu, lidhur me ndryshimet e projekt-preventivave, moszbatimet e ndjekjes së grafikut të punimeve apo moskryerjen e punimeve sipas kushteve të kontratës, gjatë vitit 2025, nuk ka pasur raste të tilla.

Lidhur me situatat e paparashikueshme, të cilat ndikojnë në sigurinë e digave, në infrastrukturën e kullimit apo strukturës së mbrotjes nga përmbytja gjatë vitit 2025, megjithëse ka patur përmbytje masive në nëntor 2025, nuk kemi pasur raste të tilla me impakt të dukshëm në infrastrukturë.

Impakti me investime për vitin 2025:

- Përmirësimi i ujitjes në rreth 16,000 ha (*8,000 ha si rezultat i rehabilitimit të disa kanaleve kryesorë ujitës në administrim të MBZHR-së dhe rreth 8,000 ha nga procesi i rehabilitimit të kanaleve ujitëse në administrim të bashkive*);

- Rehabilitimi/ndërtimin e rreth 10 km argjinatura për mbrojtjen nga gërryerja dhe përmytja të tokave bujqësore dhe zonave të banuara, më të ekspozuara nga rreziku i përmytjeve lumore kryesisht në lumenjtë kryesorë Drin, Buna, Shkumbin, Osum, Seman, Vjosa, Shushica etj;
- Rikonstruksioni i 3 hidrovoreve, Greth (bashkia Rrogozhinë), Synej (bashkia Kavajë), Hamallaj (bashkia Durrës) dhe fillimi i punimeve për rehabilitimin e hidrovorit të Orikum (bashkia Vlorë), që përmirësojnë në total kullimin e rreth 2,500 ha.

Me shpenzimet operative është mundësuar:

- Mirëmbajtja dhe funksionimi i 21 kanaleve kryesorë ujitëse dhe veprave të marrjes së ujit në administrim të DUK-ve, që kanë furnizuar me ujë rrjetin e kanaleve sekondarë për ujitjen në rreth 100,000 ha, kryesisht në ultësirën perëndimore, si dhe është realizuar pastrimi i kanaleve kryesorë ujitës, për largimin si proces ciklik vjetor të rreth 200,000 m³ dhera, kryesisht në zonat Peqin, Kavajë, Lushnjë, Fier, Divjakë, Lezhë, Shkodër etj;
- Funksionimi i 27 hidrovorë për kullimin dhe mbrojtjen nga përmytja të 70,000 ha, në ultësirën perëndimore.

■ **Objektivi 3:** Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të akteve nga strukturat përkatëse.

Në funksion të garantimi të kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin duke u bazuar në identifikimin e riskut që ka të bëjë me sigurimin e bashkëpunimit me drejtoritë teknike për programimin e projektakteve, kuptueshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore. Për njësinë përgjegjëse është shumë e rëndësishme bashkëpunimi me drejtoritë teknike kur legjislacioni është kompleks apo kur përmban parashikime të fushave teknike, pasi duhet të garantohet që këto parashikime të jenë të qarta dhe të zbatueshme jo vetëm për subjektet të cilave iu drejtohen por edhe çdo qytetari të zakonshëm.

Përmes këtij objektivi synohet rritja e cilësisë së akteve ligjore dhe nënligjore përmes bashkëpunimit të drejtorive me drejtorinë juridike, duke marrë në konsideratë mendimet e institucioneve, në varësi të nevojave institucionale gjatë proceseve të punës.

Ky objektiv përmban një numër prej një (1) mase specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilat i referohen specifikisht bashkëpunimit me drejtoritë teknike në garantimin e kuptueshmërisë të tekstit ligjor të akteve ligjore.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e drejtorisë së Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: një (1) masë në proces zbatimi.

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të akteve nga strukturat përkatëse.	Masa/ Aktivitete	1	1	0	0



Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2024* në vijim të zbatimit të kësaj mase është detyrë funksionale nga e cila varet në mënyrë direkte cilësia e produktit të punës në kuptim të garantimit të kuptueshmërisë dhe zbatimit të akteve ligjore apo n/ligjore. Në këtë kuadër për garantimin e

kuptueshmërisë janë zhvilluar takime me drejtoritë teknike përkatëse ku janë diskutuar dhe sqaruar direktivat që dirigjon akti ligjor dhe mënyra e saktë e zbatimit të tyre në praktikë. Në vazhdim nëse paraqitet nevoja atëherë veç takimeve mund të shpjegime me shkrim etj deri kur të kemi dakortësinë mbi zbatimin e saktë të aktit ligjor.

Gjatë vitit 2024 në bashkëpunim me drejtoritë teknike dhe në përputhje me PPAP, PKIE dhe prioritetet e tjera janë miratuar:

Në PPAP e vitit 2024 i miratuan 17 (shtatëmbëdhjetë) akte nga 20 projekt-akte të planifikuara (nga të cilat 12 janë projektvendime dhe 5 janë projektligje).

Në PKIE e vitit 2024 u miratuan 17 projekt-akte nga 19 akte të parashikuara

Si dhe janë miratuar jashtë planit 4 akte.


■ **Objektivi 4 : Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë.**

Përmes këtij objektivi synohet mirëfunksionimi i administratës së institucionit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve njerëzore e profesionale të fushës, rekrutimin e stafit në mungesë në përputhje me strukturën dhe organikën në fuqi të ministries, si dhe realizimit të vlerësimeve përkatëse për vitin 2024.

Në funksion të konsolidimit të sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në Ministri, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin në bazë të identifikimit të 6 risqeve:

1. Mungesa e Rregullores organizative për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 61, datë 18.4.2024, *“Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”*, për administrimin e së cilës duhet të zhvillohen takime mes nivele të larta dhe të mesme drejtuese.
2. Vakanca në MBZHR, për administrimin e së cilës duhet të plotësohet numri i vendeve vakante të aparatit.
3. Dokumenti i politikave për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, për administrimin e së cilës duhet të hartohet, miratohet dhe publikohet politika e institucionit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjithashtu zbatimi i kësaj politike duhet të reflektohet në manualët e vendeve të punës së punonjësve.
4. Paketë e akteve (ligjore dhe nënligjore) për zbatim në ushtrimin e detyrës, për nëpunësit civil/punonjësit dhe stafin politik, për administrimin e së cilës duhet të përgatitet paketa informative për ligjet dhe aktet nënligjore bazë për çdo drejtori të MBZHR-së dhe për stafin politik, e cila duhet të shpërndahet veçanërisht tek punonjësit e rinj të MBZHR-së.
5. Ruajtje e kujtesës institucionale e vijueshmëri e aktivitetit të drejtorive të MBZHR-së, për administrimin e së cilës duhet të përgatitet dhe të dorëzohen në protokoll materiali informues për

çdo pjesëmarrje në trajnime dhe grupe pune dhe përfaqësime të MBZHR-së (brenda dhe jashtë vendit).



6. Përmirësim i Programit të Transparencës për institucionin e MBZHR-së, për administrimin e së cilës Koordinator i së Drejtës së Informimit me Nëpunësin duhet të përditësojë rregullisht Programin e Transparencës.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të drejtorive të tjera teknike në MBZHR. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: katër (6) masa të zbatuara plotësisht, një (1) realizuar pjesërisht (shkak procedurat e rekrutimit, të cilat nuk ka pasur fitues).

Objektivi 4	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuar
Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë	Masa/ Aktivitete	5	4	1	0

Për këtë periudhë monitorimi, *janar-dhjetor 2024* është punuar dhe miratuar rregullorja organizative për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në zbatim të Urdherit të Kryeministrit Nr. 61, datë 18.4.2024, “Për miratimin e strukturës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, Akti i cili iu është bërë me dije stafit si dhe është publikuar në faqe zyrtare të internetit. Në lidhje me vakancat në MBZHR, vazhdimisht janë dërguar për shpallje pozicionet vakante të krijuara pas hyrjes në fuqi të strukturës së re.

Sa i përket informimit mbi paketë e akteve (ligjore dhe nënligjore) për zbatimin e ushtrimit të detyrës, për nëpunësit civil/ punonjësit dhe stafin politik, pas çdo emërimi, stafit i vendoset në dispozicion paketat me aktet e brendshme.

Lidhur me ruajtjen e kujtesës institucionale e vijueshmëri e aktivitetit të drejtorive të MBZHR, raportohet herë pas here me e-mail tek eprori direkt apo dhe në protokoll aktivite, trajnime të ndryshme apo minuta takimi për grupet e punës.

Gjithashtu, lidhur me Përmirësimin e Programit të Transparencës për institucionin e MBZHR-së, për vitin 2024, Programi i Transparencës është përditsuar dhe publikuar në vazhdimsi regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve. Janë regjistruar dhe kthyer përgjigje për 33 kërkesa.

■ **Objektivi 5:** Sigurimi i Burimeve Financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja.


Në funksion të sigurimit të burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimit të punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar procesin në bazë të identifikimit të 5 risqeve:

1. Mungesa e fondeve buxhetore, mosrealizim në kohë i detyrave operacionale me qëllim mirëfunksionimin e punës në institucion, për administrimin e së cilës duhet të zhvillohen takime dhe raportime të vazhdueshme me drejtuesit e institucioneve, Ministrinë e Financave, donatorët, etj. me qëllim sigurimin e fondeve. Gjithashtu, janë të nevojshme udhëzime nga MF për përmirësimin e procesit dhe marrjen e masave për sigurimin e buxhetit të nevojshëm.
2. Pamundësia e sigurimit të fondeve nëpërmjet financimit të huaj, për administrimin e së cilës duhet të zhvillohen takime me MF me qëllim rialokime të mundshme dhe korrektimin e planit.

3. Moskryerja në kohë e pagesave për të tretë në bazë të detyrimeve kontraktore për mangësi në dokumentacion, për administrimin e së cilës duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me drejtorinë e prokurimeve, shërbimeve mbështetëse për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për çdo pagesë.
4. Mospërgatitja në kohë e gjithë dokumenteve dhe pagesave financiare në zbatim të legjislacionit në fuqi, për nëpunësit civil/punonjësit dhe stafin politik, për administrimin e së cilës është i domosdoshëm përmirësimi i komunikimit me institucionet e varësisë.
5. Mospublikimi e gjithë informacionit financiar dhe ajo e aseteve në programin përkatës, e cila mund të administrohet nëpërmjet mbledhjes së të dhënave të nevojshme, përditësimit të informacionit brenda sektorit, si dhe plotësimit të regjistrave në kohë dhe me saktësi.
6. Përmes këtij objektivi synohet sigurimi dhe përdorimi me efektivitet dhe me efikasitet i burimeve financiare për administrimin e buxhetit, bashkërendimin e punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Grupi për Menaxhimin Strategjik, si dhe Sekretari i Përgjithshëm i MBZHR. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat e sipër cituara dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi të gjitha masat (5) të zbatuar plotësisht.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2025	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuara
Sigurimi i Burimeve Financiare për kryerjen e operacioneve/veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja.	Masa/ Aktivitete	5	5	0	0



Për periudhën e monitorimit *janar–dhjetor 2025*, nga strukturat përkatëse janë realizuar 5 masa të Planit të Integritetit, nëpërmjet plotësimit të fondeve përmes tre Akteve Normative për rishikimin e buxhetit të vitit 2025: Akti Normativ nr. 6, datë 11.06.2025; Akti Normativ nr. 10, datë 08.10.2025; dhe Akti Normativ nr. 11, datë 19.12.2025. Nëpërmjet këtyre akteve u mundësua sigurimi i fondeve, veçanërisht për mbështetjet direkte të fermerëve, dëmshpërblimin e tyre për eliminimin e kafshëve të prekura nga sëmundjet, si dhe për financimin e objekteve të ujitjes dhe mbrojtjes nga përmbytjet, të cilat, për shkak të ritmeve të shpejta të punimeve, përfunduan përpara afateve të përcaktuara në kontratë.

Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar projekte pa financim; megjithatë, për disa projekte me pritshmëri të ulët realizimi, nëpërmjet tre Akteve Normative të rishikimit të buxhetit është reduktuar plani i financimit të huaj me rreth 1.2 miliard lekë, kryesisht për programin IPARD dhe projektet e financuara nga Banka Botërore.

Si rezultat i ecursisë së punimeve me ritme të shpejta në projektet e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit gjatë vitit 2025, janë krijuar detyrime të prapambetura në vlerën 210 milion lekë, të cilat parashikohet të likuidohen gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026. Megjithëse Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka përcjellë kërkesa për shtesë të shpenzimeve kapitale në kuadër të Akteve Normative, këto kërkesa nuk u arrit të përfshiheshin në vlerën e plotë nga Ministria e Financave.

Nëpërmjet sistemit të thesarit janë vendosur masa shtrënguese për të nxitur institucionet që të mos mbartin fatura financiare përtej afatit 30-ditor kalendarik, duke synuar sigurimin në kohë të dokumentacionit të nevojshëm. Në këtë kuadër, Ministri i Financave ka miratuar udhëzimin vjetor për zbatimin e buxhetit. Realizimi i buxhetit është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk janë konstatuar raste të mungesës së dokumentacionit.

Sa i përket raportimit dhe regjistrimit të informacionit financiar, të gjithë regjistrat përkatës, përfshirë AFMIS, SIFQ, regjistrin e detyrimeve të prapambetura dhe databazën e VGJ-së, janë mbajtur të përditësuar në kohë përgjatë gjithë periudhës

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-dhjetor* 2025, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Përmbushja e Objektivave – Nga 33 masa të parashikuara për zbatim, 30 janë realizuar plotësisht, ndërsa 3 mbeten në proces, pa asnjë masë të pazbatuar.
- Lufta kundër Korrupsionit – Plani i Integritetit është zbatuar si një instrument parandalues për të rritur transparencën dhe integritetin në administratën publike të ministrisë.
- Zbatimi i Programit IPARD – Programi është vlerësuar dhe monitoruar sipas objektivave, duke identifikuar sfida kryesore si mungesa e personelit dhe koordinimi mes institucioneve.
- Administrimi i Buxhetit dhe Burimeve – Janë siguruar financime për projekte dhe operacione të ndryshme, me 5 masa të zbatuara plotësisht në këtë fushë. Janë bërë përmirësime në sistemin e pagesave dhe administrimin e fondeve.
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore – Janë bërë përpjekje për të përmirësuar menaxhimin e stafit dhe rritjen e kapaciteteve, me 6 masa të zbatuara plotësisht dhe një në proces për shkak të procedurave të rekrutimit.
- Kuptueshmëria e Akteve Ligjore – Është punuar për garantimin e qartësisë së akteve ligjore dhe për përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet drejtorive.
- Rritja e Transparencës – Ministria ka përmirësuar publikimin e dokumenteve dhe raportimeve, duke rritur qasjen e publikut dhe grupet e interesuara.
- Sfida të Identifikuara – Ka nevojë për përmirësime në koordinimin mes njësive të ndryshme të ministrisë, në rritjen e burimeve njerëzore dhe në përshpejtimin e proceseve burokratike për financimet.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të trajnohen punonjësit përkatës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për proceset përkatëse të punës.
- Të plotësohen vakancat në ministri në të gjithë strukturat ku rezultojnë;

Aneks

- Aneksi i raportimit të informacionit nga njësitë kontribuuese

Objektivi Nr. 1: Hartimi, monitorimi, vlerësimi i Programit IPARD dhe raportimi mbi zbatimin e tij

Plani i integritetit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Nr.	Risku dhe faktorërt e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	Realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
Nënobjektivi Nr.1 Akreditim i masave ekzistuese dhe realizimi i thirrjeve në kuadër të Programit IPARD III							
1.1	Mungesa e kontributeve të sakta dhe në kohën e duhur nga institucionet e tjera.	Përputhshmërie Reputacional	I moderuar	Bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe komunikim i vazhdueshëm	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD	6 M-I-2025	Në 6 mujorin e I-rë 2025 është dorëzuar në afat, pranë Komisionit Evropian, Raporti Vjetor i Zbatimit për vitin 2024 dhe Raporti Final të Zbatimit për periudhën 2014-2024. Gjatë kësaj periudhe, këto raporte janë konsultuar me DG-AGRI dhe janë miratuar nga anëtarët e Komitetit të Monitorimit të IPARD II. Janë dorëzuar sipas afateve raportet sipas kërkesave të DG Agri dhe Zyrtarit Kombëtar Autorizues.
	Mosrespektimi i afateve të raportimeve në DG Agri	Përputhshmërie	I moderuar	Koordinimi i procesit në bashkëpunim me institucionet e tjera. Organizimin dhe pjesëmarrje në takimet me institucionet.	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD	6 M-II-2025 e ne vazhdim	
1.2	Mosrealizimi në kohë dhe në mënyrën e duhur i proceseve të punës	Operacional	I ulët	Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Burimeve Njerëzore	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	6 M-II 2024	Në Drejtorinë e Programimit dhe Monitorimit IPARD nuk ka vende vakante.
	Personel i pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar proceset e rëndësishme	Operacional	I ulët	Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	6 M-II 2024	

Nënobjektivi Nr. 2 Akreditimi i masave të reja në kuadër të Programit IPARD III							
2.1	Mosrealizimi në kohë dhe në mënyrën e duhur i proceseve të punës	Operacional	I ulët	Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Burimeve Njerëzore	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	6 M-II 2024	Në lidhje me Programin IPARD III, po vijon puna përgatitore për përgatitjen e stafit të kësaj drejtorie dhe jo vetëm. Janë organizuar trajnime të ndryshme me asistencë nga BE përmes instrumentit të TAIEX; FAO si dhe trajnimeve të ofruara nga ASPA ku stafi i Autoritetit Menaxhues dhe Agjencisë IPARD ka marrë pjesë. Gjithashtu janë realizuar edhe trajnime specifike me fokus masat e reja të programuara nën këtë program. Është bërë plotësimi i 2 vendeve vakante "Specialist" në Sektorin e Programimit.
	Personel i pamjaftueshëm për një kohë të konsiderueshme për të mbuluar proceset e rëndësishme	Operacional	I ulët	Ndjekja e procedura të rekrutimit dhe komunikimi i vazhdueshëm me Sektorin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore	6 M-II 2024	
Nënobjektivi Nr. 3 Realizimi i vlerësimit ex-post për programin IPARD II							
3.1	Mosrealizimi në kohë i vlerësimit ex-post të Programit IPARD II	Përputhshmërie	I ulët	Bashkëpunim i ngushtë me Drejtorinë e Prokurimeve për ndryshimin e regjistrit të prokurimeve, hartimin e termave të referencës, hapjen e procedurës dhe zhvillimin e saj.	Drejtoria Programimit dhe Monitorimit IPARD Drejtoria e Prokurimeve	6 M-II 2025	Autoriteti Menaxhues ka hartuar dhe dorëzuar pranë Komisionit Evropian, brenda afatit të përcaktuar në Marrëveshjen Sektoriale, Raportin Final të Vlerësimit Ex-post të Programit IPARD II.

Objekti Nr. 2: Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave

Plani i integritetit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural							
Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	Realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
Objekti nr. 2							
Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe administrimit të buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët zhvillimorë me qëllim rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave							
1	Mosardhja në kohë e udhëzimeve dhe tavanave nga Ministria e Financave (MF).	Përputhshmëri	I ulët	Mbajtja e vazhdueshme e kontakteve me MF nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit.	Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave	2025-2027	Nga Sektori i Buxhetit (Koordinuesi i PBA), janë adresuar në kohë tavanet buxhetore dhe ka përfunduar në afat përgatitja e PBA-së 2025-2027
2	Mosmbërritja në kohë dhe me cilësi e informacionit mbi nevojat për fonde nga institucionet e varësisë, drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit.	Përputhshmëri	I moderuar	Mbajtja në kontakt të vazhdueshëm dhe këshillimi i stafit të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së planifikimit buxhetor.	Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave	2025-2027	Informacioni standard për përgatitjen e buxhetimit për vitin 2025 është sjellë në kohë nga DUK-të për dy fazat e përgatitjes së PBA-së (strategjike në Prill dhe teknike në Gusht)
3	Mosakordimi i plotë i fondeve buxhetore të kërkuara për shpenzime operative dhe investimet.	Financiar	I moderuar	Argumentimi sa më i plotë teknik dhe ligjor i nevojave për fonde buxhetore.	Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave	2025-2027	Nuk ka pasur shmangie nga tavanet buxhetore të planifikuara. Në tavanet buxhetore është bërë një shpërndarje e drejtë e shpenzimeve operative dhe investimeve, pavarësisht kërkesave shtesë, si pasojë e përmbytjes të vitit 2026
4	Zhvillime të reja lidhur me politikat e qeverisë për prioritetet e zhvillimit rajonal, etj.	Përputhshmëri	I ulët	Rishikim prioritetesh në funksion të politikës rajonale.	Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave	2025-2027	Nuk kemi pasur ndryshim të prioritetit të qeverisë për ndërhyrjet në infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit
5	Mosrakordimi i fondeve të kërkuara gjatë fazës së identifikimit të projekteve	Financiar	I moderuar	Përshtatja e prioriteteve në funksion të tavanave buxhetore të limituara.	Drejtoria e Administrimit të Ujërave dhe Digave	2025-2027	Identifikimi i projekteve të nevojshëm për t'u investuar është gjithmonë më i lartë se tani buxhetor, si në rastin e nevojave për përgatitjen e projekteve të zbatimit, ashtu dhe për implementimin e këtyre projekteve .
6	Hartimi me një cilësi të dobët i termave të referencës	Operacional	I moderuar	Nevoja për përmirësimin dhe unifikimin e standardeve të projektimit	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Nuk kemi pasur raste të kontestimit të TORS, të përgatitura nga DUK-të për objektet e infrastrukturës së ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja.
7	Mospërgatitja në kohë e projekteve të zbatimit, sipas termave të referencës	Operacional	I lartë	Respektimi i afateve nga palët sipas kontaktave	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Gjatë vitit 2025, nuk ka patur vonesa në procedurën e prokurimit dhe janë realizuar projektet e zbatimit.

8	Vonesat e procedurave të prokurimit.	Operacional	I lartë	Ndjekja e afateve të procedimit sipas legjislacionit.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Gjatë vitit 2025, përveç zhvillimit të procedurave të prokurimit, ka patur vonesa në dhënien e lejeve përkatëse për fillimin e punimeve.
9	Ndryshimet e projekt – preventivave gjatë zbatimit	Përputhshmëri	I moderuar	Rritje e kontrollit për ecurinë e projekteve dhe për zbatimin e tyre.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Për vitin 2025 nuk kemi pasur raste të ndryshimit të projekteve të zbatimit gjatë implementimit
10	Mospërputhje e grafikut të miratuar të punimeve me kushtet klimaterike të objekteve.	Përputhshmëri	I moderuar	Bashkërendim midis drejtorive përkatëse.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Financimet e parashikuara për vitin 2025 janë realizuar sipas planit, madje kemi pasur avancim të punimeve në raport me financimin e parashikuar për vitin 2025, për objektet në vazhdim 2025-2027.
11	Moskryerja e punës sipas termave të referencës dhe kushteve të kontratës nga supervizori	Përputhshmëri	I moderuar	Rritje e përgjegjshmërisë dhe trajnimeve të specialistëve të DUK-ve në zbatimin e ligjit	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Nuk janë raportuar nga DUK-të raste të tilla
12	Mospërputhje e grafikut të punimeve me grafikun e likuidimeve.	Përputhshmëri	I moderuar	Rishikimi i grafikut të punimeve në përputhje me mundësinë e likuidimeve.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Financimet e parashikuara për vitin 2025 janë realizuar sipas planit, madje kemi pasur avancim të punimeve në raport me financimin e parashikuar për vitin 2025, për objektet në vazhdim 2025-2027.
13	Situata të paparashikuara natyrore (përmbetje, tërmete) që afektojnë infrastrukturën e kullimit	Operacional	I lartë	Mbikëqyrje e vazhdueshme e zonave me risk të lartë dhe rialokim shpenzim/investim në raste të nevojshme.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Gjatë vitit 2025, kemi pasur situata të përmbetjeve masive në nëntor të vitit 2025, me ndikim në infrastrukturën e kullimit dhe realizimin e investimeve në hidrovore.
14	Situata të paparashikuara natyrore (përmbetje, tërmete) që ndikojnë në sigurinë e digave.	Operacional	I lartë	Mbikëqyrje e vazhdueshme e zonave me risk të lartë dhe rialokim shpenzim/investim në raste të nevojshme.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Gjatë vitit 2025, kemi pasur situata të përmbetjeve masive në nëntor të vitit 2025, që të ndikojnë në sigurinë e digave, megjithëse monitorimi i sigurisë së tyre nga bashkitë kërkon një anagzim shumë më të madh teknik dhe financiar.
15	Situata të paparashikuara natyrore (përmbetje, tërmete) që afektojnë strukturat e mbrojtjes nga përmbetja.	Operacional	I lartë	Mbikëqyrje e vazhdueshme e zonave me risk të lartë dhe rialokim shpenzim/investim në raste të nevojshme.	Drejtoritë e Ujitjes dhe të Kullimit	2025-2027	Gjatë vitit 2025, kemi pasur situata të përmbetjeve masive në nëntor të vitit 2025, që të afektonin infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbetja (dëmtime të argjinaturave etj)

Objekti Nr. 3: Garantimi i kuptueshmërisë dhe i vënies në zbatim të aktiveve nga struktura përkatëse.

Plani i integritetit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural							
Nr.	Risku dhe faktorët e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
1.1	Sigurimi i bashkëpunimit me drejtoritë teknike lidhur me programimin e projektakteve, kuptueshmërinë dhe zbatimin e akteve ligjore	Përputhshmërie	I lartë	Bashkëpunimi me drejtoritë teknike është i rëndësishëm së lartë sidomos në rastet kur akti ligjor apo n/ligjor paraqitet kompleks apo përmban një sërë parashikimesh rregullatore në varësi të fushës së zbatimit. Për të garantuar kuptueshmërinë edhe për qytetarët e zakonshëm, për të shmangur keqkuptimet apo përdorimin e nënkuptimeve, roli i teknikut është shumë i rëndësishëm pasi në fusha e përgjegjësisë së MBZHR është tepër specifike si mbrojtja e bimëve, fusha e peshkimit, tokat bujqesore, veterinaria etj. Ndonjëherë, fjalët kanë kuptime të ndryshme në varësi të kontekstit rregullator të aktit ligjor ndaj bashkëpunimi me ekspertin është vendimtar jo vetëm që akti ligjor të jetë i kuptueshëm por edhe të garantohet zbatimi sa më eficient i tij. Ky proces është i rëndësishëm së lartë pasi sic u përmënd më lart, tekstet e akteve ligjore/nenligjore zbatohen në praktikë nga njerëz të cilët jo detyrimisht janë nëpunës. Ndaj në këtë aspekt juristi bashkëpunon ngushtë me ekspertin që teksti i aktit ligjor të jetë jo vetëm rregullues dhe përcaktues në objektin e tij por edhe i kuptueshëm dhe praktik gjatë zbatimit të tij.	Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator	Në vijim	Gjatë vitit 2025 në bashkëpunim me drejtoritë teknike dhe në përputhje me PPAP, PKIE dhe prioritetet e tjera janë miratuar: Për PPAP e vitit 2025 miratuar me VKM nr. 818, datë 26.12.2024, 3 (tre) akte nga 10 projekt-akte të planifikuara (nga të cilat 1 është projektvendim dhe 2 janë projektligje). Në PKIE e vitit 2024 -2026, gjatë vitit 2025 u miratuan 12 projekt-akte (nga të cilat 1 është udhëzim, 10 janë urdhra dhe 1 është projektligj). Si dhe janë miratuar jashtë PPAP 2025, 7 (shtatë) akte, të cilat janë projektvendime.



Objektivi Nr. 4: Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministri.

Plani i integritetit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural							
Nr.	Risku dhe faktorërt e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
1	Mungesa e Rregullores organizative per Ministrine e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural, ne zbatim te Urdherit te Kryeministrit nr.61 date 18.4.2024,” Per miratimin e struktures se Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural”	Operacional	I mesem	Ndjekja e procedures se brendshme me Takime ne nivel Drejtor Te pergjithshem dhe Drejtor Drejtorie	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative	2024	Realizuar Eshte miratuar Me urdher te Ministrit nr.957 date 13.11.2024 "Per miratimin e rregullores per organizimin dhe funksionimin e brendshem te Ministrise se Bujqesise dhe Zhvillimit Rural"
2	Vakanca ne MBZHR	Operacional	I mesem	Të plotësohen numri i vendeve vakante në Aparatin e MBZHR-se	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative	2024-2027	Ne proces sipas planit e shpalljeve ne dap. Emerimi i fundit per vitin 2024 eshte kryer me 24.12.2024 (staf ne sherbimin civil)
3	Paketë e akteve (ligjore dhe nënligjore) për zbatim në ushtrimin e detyrës, per nëpunësit civil/ punonjesit dhe stafin politik	Operacional	I ulët	Pregatitje e paketës informative për ligjet dhe aktet nënligjore bazë për çdo drejtori të MBZHR dhe stafi politik. Shpërndarje e paketës informative tek punonjësit e rinj të MBZHR	Të gjitha drejtoritë	2024-2027	Pas cdo emerimi njoftohen me aktet e posacme
4	Ruajtje e kujtesës institucionale e vijueshmëri e aktivitetit të drejtorive të MBZHR	Operacional	I moderuar	Material informues të dorëzuara në protokoll për çdo pjesëmarrje në trajnime dhe grupe pune dhe përfaqësime të MBZHR -se (brenda dhe jashtë vendit)	Të gjitha drejtoritë /Sektori I Arkive Protokollit	2024-2027	Raportohet herë pas here me e-mail tek eprori direkt apo dhe në protokoll aktivite, trajnime të ndryshme apo minuta takimi për grupet e punës.
5	Përmirësim i Programit të Transparencës per institucionin e MBZHR-se	Operacional	I moderuar	Të përditësohet rregullisht Programi i Transparencës.	Koordinatori i te drejtes se Informimin ne nepunesin qe do te percaktohet	2024-2027	Programi i Transparencës është përditsuar dhe publikuar në vazhdimsi regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve për vitin 2025. Janë regjistruar dhe kthyer përgjigje për 56 kërkesa.

Objektivi Nr. 5: Sigurimi i burimeve financiare për kryerjen e operacioneve/ veprimtarisë, planifikimi dhe administrimi i buxhetit, bashkërendimi i punës me donatorët dhe partnerët për rritjen e financimeve të huaja.

Plani i integritetit i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural							
Nr.	Risku dhe faktorërt e riskut	Kategoria e faktorëve të riskut	Niveli i prioritetit të aktiviteteve: i lartë, i moderuar, ose i ulët	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për administrimin e faktorëve të riskut	Struktura përgjegjëse për aktivitetet e parashikuara	Afati	realizimi (informacionin konkret lidhur me masën e realizimit, cito akte nëse ka të tilla)
1	Mungesa e fondeve buxhetore, mosrealizim në kohë i detyrave operacionale me qëllim mirëfunksionimin e punës në institucion.	Financiar	I lartë	Takime dhe raportime të vazhdueshme me drejuesin e institucionit, MF, donatorët, etj., me qëllim sigurimin e fondeve. Udhëzime nga MF për përmirësimin e procesit, marrjen e masave për sigurimin e buxhetit të nevojshëm.	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR GMS	2024-2027	Në funksion të vënies në dispozicion të fondeve, veçanërisht për mbështetjet direkte ndaj fermerëve, si dhe për dëmshpërblimin e tyre për kafshët e eliminuara si pasojë e sëmundjeve, gjatë vitit 2025 janë miratuar tre Akte Normative për rishikimin e buxhetit: Akti Normativ nr. 6, datë 11.06.2025; Akti Normativ nr. 10, datë 08.10.2025; dhe Akti Normativ nr. 11, datë 19.12.2025.
2	Pamundësia e sigurimit të fondeve nëpërmjet financimit të huaj.	Reputacional	I lartë	Takime me MF me qëllim rialokime të mundshme dhe korrektimin e planit	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR GMS	2024-2027	Gjatë vitit 2025 nuk janë evidentuar projekte pa financim; megjithatë, për shkak të pritshmërive të ulëta të realizimit për disa projekte, nëpërmjet tre Akteve Normative për rishikimin e Buxhetit 2025 është reduktuar plani i financimit të huaj me rreth 1.2 miliard lekë. (Kryesisht projekti për programin IPARD dhe projekti i Bankës Botërore).

3	Moskryerja në kohë e pagesave për të tretë në bazë të detyrimeve kontraktore për mangësi në dokumentacion.	Reputacional	I mesëm	Komunikim i vazhdueshëm me Drejtorinë e Prokurimeve, Shërbimit. Plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për çdo pagesë.	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR SP	2024-2027	Si rezultat i ecurisë së punimeve me ritme të shpejta në projektet e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit gjatë vitit 2025, janë krijuar detyrime të prapambetura në vlerën 210 milion lekë, të cilat parashikohet të likuidohen gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026. Megjithëse Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural gjatë vitit 2025 ka përcjellë një kërkesë për shtesë të shpenzimeve kapitale në kuadër të Aktit Normativ, kjo kërkesë nuk u mundësua të përfshihej vlera e plotë nga Ministria e Financave në Aktet Normative.
4	Mospërgatitja në kohë e gjithë dokumentave dhe pagesave financiare në zbatim të legjislacionit në fuqi.	Financiar	I lartë	Komunikim i vazhdueshëm me institucionet e varësisë.	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR SP	2024-2027	Realizimi i buxhetit është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk janë konstatuar raste të mungesës së dokumentacionit.
5	Moshedhja e gjithë informacionit financiar dhe ajo e aseteve në programin përkatës.	Financiar	I mesëm	Mbledhja e të dhënave të nevojshme. Përditësimi i informacionit përkatës brenda sektorit. Plotësimi i regjistrave në kohë dhe me saktësi.	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar MBZHR	2024-2027	Të gjitha ngjarjet ekonomike janë regjistruar në sistemet përkatëse të thesarit, si SIFQ dhe AFMIS.